



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:108231

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05465181

P. nr. 2022:108232

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas gjyqtarit Adem Shabani, me pjesëmarrjen e Zyrtares ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurit R.G., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...”nr....., (më herët ka jetua në lagjen “...” në Prishtinë) i akuzuar për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.788/2022 e datës 27.05.2022, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, dhe i pandehuri R.G., me datën 20.02.2024 të njëjtën ditë morri dhe publikisht komunikoi kurse me datën 18.03.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

- R.G., me vendbanim në Prishtinë, rruga “...” nr....., (më herët ka jetua në lagjen “...” në Prishtinë), i lindur më datë ..., në M., Komuna Prishtin, nga i ati R. dhe e ëma S., të vajzërisë B., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë i martuar, baba i katër fëmijëve ka biznesin e tij personal ka të kryer shollën e lartë, me gjendje të mesme ekonomike, më numër personal ..., mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

- Me datë 24.04.2022, në rrugën “...” ,në Ferizaj, i pandehuri i cili kishte qenë në lidhje me të dëmtuarën N.D., përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme , duke komunikuar me qëllim të ngacmimit- në atë mënyrë që, pasi dëmtuara ndahet nga i pandehuri dhe kthehet në Ferizaj për të jetuar, i pandehuri fillon të publikojë në rrjetin social Facebook postime, ku fillimisht e thërret shoqen e të dëmtuarës duke i thënë ” *a e dini çfarë shoqe keni ju, sepse ajo është kurvë* “, e më pas i publikon disa pastime, ku e

shpallë të dëmtuarën si person të humbur ,duke shënuar në postime se e dëmtuara ishte trafikuar nga D.N., ku kinse është zhdukur, me ç'rast i pandehuri e shënon në postim se i ofron 5000 euro shpërblim për gjetjen e të dëmtuarës dhe në këtë mënyrë, i shkakton të dëmtuarës shqetësim emocional.

-Me këtë ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182 par 1 të KPRK.

Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 38, 39 par1 nënpar 1.1, 40 par.1. nën par 1.3, 43, 69, 70, 71, të KPK-së dhe nenit 358, 359, 360, 361, 364, 365, 449, 462, të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), e

G J Y K O N

Të pandehurit **R.G.**, i shqipton : dënim me gjobë në shumën prej 200 Euro (dyqind euro) të cilën duhet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund të zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim duke e zëvendësuar dënimin me gjobë në dënimin me burgim, ashtu që 1 (një) ditë burgim llogaritet me 20 € (njëzet) euro gjobë, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së,.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë euro), si dhe në bazë të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet Euro), në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara N.D., me vendbanim në rrugën “ ... ” në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridik është udhëzuar në procedure civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm me akuzën PP/II.nr.788/2022 e datës 27.05.2022, ka ngarkuar të akuzuarin R.G., me vendbanim në Prishtinë, rruga “ ... ”nr...., (më herët ka jetua në lagjen “ ... ” në Prishtinë) për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 20.06.2022, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar por i akuzuari R.G., edhe pas udhëzimeve nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që akuzohet.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 245 paragrafi 6 dhe neneve 249 dhe 250 të KPPRK-së (Kodit të Procedurës Penale që ishte në fuqi), e ka udhëzuar të akuzuarin se mundë të paraqet prova për kundërshtimin e aktakuzës apo kërkesë për hedhjen e aktakuzë.

I akuzuari R.G., në afatin ligjor në gjykata me datën 27.07.2021 ka paraqitur kundërshtimin e provave kundër aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.686/2021 e datës 14.06.2021 lidhur me veprën penale që akuzohet.

Gjykata duke vepruar konform nenit 250 paragrafi 3 të KPPRK-së(Kodit të Procedurës Penale që ishte në fuqi), ka shqyrtuar dhe analizuar kërkesën e parashtruar nga, i akuzuari por në këtë fazë të procedurës penale me datën 05.09.2022 ka sjell Aktvendim ku ka Refuzuar si të pabazuar kërkesë e paraqitur nga i akuzuari R.G., për hedhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale për veprën penale që akuzohet, në këtë fazë të procedurës pasi që në shqyrtimin kryesor të akuzuarit do ti ofrohet mundësia e shqyrtimit të provave të propozuara nga prokurori i shtetit apo edhe nga I akuzuari duke mos i dhënë vlerë të paracaktuara asnjë prove dhe pa prejudikuar epilogun përfundimtar të këtij gjykimi.

I akuzuari R.G., me datën 28.02.2023,në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ka ushtruar ankesë kundër Aktvendimit P.nr.2022:108232 i datës 05.09.2022, lidhur me refuzimin e kërkesës për hudhjen e aktakuzës PP/II.nr.788/2022 e datës 27.05.2022 i akuzuar për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit R.G., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.2022:108232 i datës 05.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 04.04.2023 ka marrë Aktvendim ku ka Refuzuar ankesën si të pa bazuar të akuzuarit R.G., në këtë fazë të procedurës penale, dhe në shqyrtimin gjyqësor, në mënyrë që të bëhet administrimi i provave dhe të vërtetohet gjendja faktike.

Gjykata për datën 10.07.2023, ka caktuar shqyrtimin kryesor dhe vendbanimin ku ai banon i'u është dërguar ftesa për seancë por dorëzuesi i ftesave në fletë kthesë ka theksuar se me datën 09.0.2023 në adresën e kërkuar pala është i pa njohur, edhe pala e dëmtuar është ftuar me ftesë të rregullt por shpërndarësi i ftesave me datën 17.07.2023 njofton gjykatën se e ka ndërruar vendbanimin.

Gjykata në vazhdim në këtë çështje penale ka marrë veprime ligjore dhe për datën 24.07.2023 ka caktuar seancën ligjore por për të akuzuarin R.G. dhe të dëmtuarën N.D. thuhet se nuk jetoj në adresat e kërkuara.

Gjykata me datën 14.11.2023 për të akuzuarin R.G., Stacionit Policor në Prishtinë, I ka lëshuar kërkesë për verifikimin e adresës së vendbanimit për të pandehurin, ku ka pranuar njoftimin me datën 07.12.2023 se i pandehuri R.G., jeton në Prishtinë në rrugën” ... ”nr...,

mirëpo i njëjti sipas njoftimit të pranuar nga banorët kësaj lagje i akuzuari R.G., nuk gjendet në Kosovë por ka shkuar në shtetin e Austrisë.

Gjykata në vazhdim për të akuzuarin R.G., bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të nenit 535 par1 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), me datën 07.12.2023, ka lëshuar Letërreshtim Qendror, dhe kur i akuzuari R.G., po sa të sigurohet menjëherë duhet të arrestohet dhe të sillet në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Në bazë të Letërreshtim Qendror të lëshuar për të akuzuarin R.G., nga policia e Kosovës, Gjykata është njoftuar se i akuzuari në pikën kufitare në G., me datën 19.02.2023 është ndalur dhe është njoftuar se nga Gjykata Themelore në Ferizaj, i'u ka lëshuar Urdhëarrest pasi që deri më tani nuk ka mundur që t'u sigurohet për zhvillimin e rregullt të procedurës penale për veprën penale që akuzohet, ku për këtë është njoftuar edhe Gjykata, ku gjyqtari i çështjes i njofton Policinë e Kosovës, që i akuzuari R.G., të paraqitet në Gjykatë me datën 20.02.2024 ku edhe është paraqitur në 09:40 h. për këtë Gjykata e ka njoftuar edhe prokurorin e shtetit që të mbahet seanca gjyqësore.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 20.02.2024, ka marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini, dhe i akuzuari R.G., kurse e dëmtuara N.D. në shqyrtimet caktuara ishte ftuar me ftesa të rregullta, por shpërndarësi i ftesave në fletë dërgesën për dorëzim personale e ka njoftuar gjykatën se e njëjta nuk jeton në adresën e kërkuar. Dhe ani nuk dihet se ku jeton.

Gjykata edhe në shqyrtimin gjyqësor e ka ftuar të akuzuarin R.G., përsëri të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 319 parag.2.1,2.2 2.3 dhe 2.4 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032).

Prokurori i shtetit edhe në shqyrtimin gjyqësor të akuzuarit i ka lexuar aktakuzën dhe pas leximit gjyqtari është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi aktakuzën për veprën penale të cilën është akuzuar dhe të njëjtit përsëri i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë lidhur me veprat penale për të cilën akuzohen.

I akuzuari R.G., në shqyrtimin gjyqësor lidhur me veprën penale që akuzohet deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet dhe tani me të dëmtuarën nuk kam kurrfarë problemi dhe asnjë të keqe dhe i premtoj gjykatës se më nuk do të përsërisë veprime të tilla i propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese.

Gjyqtari i vetëm gjykues bazuar në nenin 322 paragrafi 2 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) ka marrë edhe mendimin e prokurorit të shtetit, ku prokurori i shtetit, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqë i njëjti pranim është i bazuar me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, dhe pranimin e fajësisë i njëjti e bëri vullnetarisht.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas marrjes së mendimit të palëve, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 322 par 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Avdullah Abedini, ka deklaruar pasi që i pandehuri e pranon fajësinë në filli të shqyrtimit gjyqësor atëherë gjendja faktike është vërtetuar ashtu siç përshkruhet në aktin akuzues, kjo ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj konform ligjit, sa i për ketë llojit dhe lartësisë se dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat rendues dhe lehtësuese ashtu që me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehuri R.G. në fjalën përfundimtare pranon se mbetem pran deklarimit që të thash në fillim të shqyrtimit gjyqësor dhe i premtoj gjykatës se me të dëmtuarën nuk kam diçka problem jam mbajtës i familjes prindër i katër fëmijëve siç deklarova edhe më lartë me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësues.

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim neni 242 par.2 nën.par.2.1, 2.2,2.3, 2.4 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), është e bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale si: Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarës dëshmitares në polici me datë 03.05.2022; Procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurit në polici me datë 11.05.2022; Sms nga rrjeti social Facebook, Lista e thirrjeve nga telefoni mobil i të dëmtuarës dhe foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera të lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në fillim të shqyrtimit kryesor i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin për veprën penale që e ka kryer, premtimin se kundër të dëmtuarës nuk do të përsëris veprime të tilla apo të ngjashme, dhe me të nuk ka asgjë të keqe, Gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuari si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale dhe është e bindur se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit do të arrihet qëllimi i paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimin për udhëzimin e palëve të dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është marrë bazë të nenit 462 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.9 të KPP-së.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr 2022:108232 me datë 18.03.2024

Zyrtare ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari,

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.